



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 558, datë 12.11.2020

PËR

**MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE NË SHPENZIME
OPERATIVE, TË PROGRAMIT 03310 “BUXHETI GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 12, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore “Shpenzime Operative”, brenda programit “Buxheti Gjyqësor” të shumës prej 4,400,000 lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore “Shpenzime kontribute për sigurime shoqërore dhe shendetësore”, të shumës prej 100,000 lekë brenda programit “Buxheti Gjyqësor”, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Pakësohet

Tabela 1. Lista e Gjykatave me kërkesa për fonde shtesë

Shtohen

Në lekë

Nr.	Emërtmi	Kërkesa për fonde shtesë
-----	---------	--------------------------

		601	602
1	Gjykata e Apelit Korçë		200,000
2	Gjykata e Apelit Vlorë		300,000
3	Gjykata Rrethit Gjyqësor Durrës		300,000
4	Gjykata Rrethit Gjyqësor Elbasan		2,000,000
5	Gjykata Rrethit Gjyqësor Pogradec	100,000	
6	Gjykata Rrethit Gjyqësor Vlorë		1,600,000
	Totali	100,000	4,400,000

Tabela 2. Lista e Gjykatave me fonde të lira për t'u përdorur

Pakësohen

Në lekë

Nr.	Emërtmi	Fonde të lira	
		601	602
1	Gjykata e Apelit Shkodër		1,000,000
2	Gjykata Rrethit Gjyqësor Dibër		500,000
3	Gjykata Rrethit Gjyqësor Fier		1,000,000
4	Gjykata Rrethit Gjyqësor Mat		400,000
5	Gjykata Administrative Shkalla parë Tiranë		500,000
6	KLGG " Programi 03310 "	100,000	1,000,000
	Totali	100,000	4,400,000